

55141143-25-3-2014 dt. 9.1.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

Bruga Nazim Gafurri 31, 10000 Prishtinë, Kosovë / Ulica Nazim Gafurri 31, 10000 Priština, Kosovo / Nazim Gafurri 31, 10000 Prishtina, Kosovo

VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Ndërmarrja: Preduzeće: Enterprise:

1. Trepça

Socially Owned Enterprise • Mining and Metallurgy-Chemical Combine

Paditës
Tužilac
Claimant

I paditur
Tuženi
Respondent

Titulli i Dokumentit:
1 Aktvendim nga Dhoma

Naziv dokumenta:
Rešenje komore

Document Name:
Decision of the Chamber

Datë Datum Dated
8.1.2015

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

AC-I-14-0247-A0001

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT


Pursuant to Law no 04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

9.1.2015

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

Përfaqësues
Punomočnik
Representative



Pala: Stranka: Party:
Pranuar nga: Primio: Received by:
Titulli: Zvanje: Title:
Data: Datum: Date:
Nënshkrimi Potpis: Signature:


AKP-PRISHTINE

09 JAN 2015

Në bazë të nenit 25.8 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033, të gjitha parashtresat dhe dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe të shoqërohen edhe me përkthimin në gjuhën angleze.

Na osnovu člana 25.8 Dodatka Zakona br. 04/L-033, svi podnesci i prateći dokumenti moraju da budu podneseni na albanskom ili srpskom jeziku zajedno s prevodom na engleski jezik.

Pursuant to Section 25.8 of the Annex of the Law no 04/L-033, all pleadings and supporting documents must be submitted either in Albanian or in Serbian accompanied by an English translation.



për shkrimorën - za pisarnicu - for registry

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
QË LIDHEN ME
AGJENCINË KOSOVARE
TË PRIVATIZIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON
PRIVATIZATION AGENCY
OF KOSOVO RELATED
MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU AGENCIJU
ZA PRIVATIZACIJU

AC-I.-14-0247

Në ankesën e

Parashtrues/Ankues

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Duke vepruar si administratore e Ndërmarrjes në pronësi shoqërore
"Trepça"

nën adminsitrimin e AKP-së

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ondrej Pridal, Gertraud Marx Leitenberger, Ilmi Bajrami dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankueses, të parashtruar ndaj aktvendimit të Kolegjit të Specializuar, të datës 31 korrik 2014, C-V-14-0007, pas seancën vendimmarrëse të mbajtur më 8 janar 2015 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa është e pabazuar**
- 2. Vërtetohet aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-V-14-0007 të datës 31 korrik 2014.**

3. Me qëllim të qartësimit të dispozitivit, pika 2 e aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-V-14-0007 të datës 31 korrik 2014 duhet të jetë siç vijon: Kërkesa e AKP e parashtruar në cilësinë e njëjtë për zgjatjen e afatit të fundit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit për „Ndërmarrjen Trepça“ aprovohet deri me 2 shkurt 2015.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 10 korrik 2014 Agjencia Kosovare e Privatizimit (duke vepruar si administrator i NSH "Trepça") parashtrroi kërkesë duke kërkuar nga DHPGJS-ja zgjatjen e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve e cila do të mbahet jo më vonë se 30 qershori 2015 dhe për zgjatjen e afatit e fundit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit deri me 31 dhjetor 2015. Parashtruesi gjithashtu propozoi të detyrohet AKP-ja që të shpallë njoftim zyrtar për zgjatjen e afateve; pastaj të detyrojë veten të dërgojë letra të veçanta informuese të gjithë kreditorëve të ditur të cilët kanë parashtruar kërkesa kreditore, duke i njoftuar ata për zgjatjen e afatit të paraparë sipas pikës 1 dhe 2 të propozimit brenda 30 ditëve nga dita e pranimi të vendimit të gjykatës dhe gjithashtu për të detyruar AKP-në të shpallë vendimin e gjykatës në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë.

AKP-ja ka deklaruar se propozimi i saj është në përputhje me nenet 7.1, 42.1, 42.3, 42.4 dhe 42.5 të Ligjit 04/L-035, për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Riorganizim). Kërkesa për zgjatjen e afatit për caktimin e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve dhe zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit për Riorganizim, është e bazuar në interesin e përgjithshëm të ndërmarrjes "Trepça" dhe në përputhje me mandatin e AKP-së për të ruajtur dhe rritur vlerën Ndërmarrjes.

AKP-ja e informoi gjykatën se Bordi i Drejtorëve të AKP-së nuk është i kompletuar me të gjithë anëtarët siç parashihet me nenin 12, duke patur

vetëm 5 anëtarë përfshirë 2 ndërkombëtarë, ndërsa ajo duhet të ketë 8 anëtarë, përfshirë 3 ndërkombëtarë. Emërimet e anëtarëve të rinj nga ana e Kuvendit të Kosovës janë problematike, duke pasur parasysh se Kuvendi i Kosovës nuk është funksional qysh prej zgjedhjeve parlamentare të qershorit. Për shkak të përbërjes jo të plotë të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, mundësia e Administratorit për të kryer detyrat e tij siç janë të përcaktuara sipas Ligjit të AKP-së janë shumë të kufizuara.

AKP-ja gjithashtu theksoi se tenderi për përzgjedhjen e ofruesit të shërbimeve profesionale ka dështuar meqë vetëm një ofertë ishte kualifikuar (nga nëntë sosh), ndërsa duhej të ishin të paktën dy.

AKP-ja ka pranuar se as nuk është në gjendje për kryerjen e vlerësimit të kërkesave të kreditorëve dhe regjistrimin e të gjitha aseteve të Ndërmarrjes, e as për të përgatitur Planin e Riorganizimit pa angazhimin e ofruesit të shërbimeve profesionale për shkak të numrit të saj të kufizuar të stafit.

Më 31 korrik 2014 Kolegji i Specializuar ka lëshuar aktvendimin C-V.-14-0007, ku vendosi që:

1. Kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e paraqitur në cilësinë e Administratorit " Ndërmarrjet Trepça" për zgjatjen e afatit për thirrjen për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve hedhet poshtë si e papranueshme.
2. Kërkesa e AKP e parashtruar në cilësinë e njëjtë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit për Riorganizimin e "Ndërmarrjeve Trepça" aprovet për periudhën deri më 2 prill 2015.
3. AKP-ja këshillohet të dorëzojë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës një raport të shkurtër mbi planet e tyre të ardhshme mbi Riorganizimin jo më vonë se 30 ditë pas njoftimit të këtij aktvendimi.
4. Ky aktvendim duhet të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë.

5. Njoftimi për zgjatjen e afatit të Planit për Riorganizim duhet të publikohet përmes gazetave siç parashihet në nenit 43 të Ligjit 04/L 035.

Kolegji i Specializuar, lidhur me propozimin për zgjatjen e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve, ka arsyetuar se kjo është kërkesa e dytë për një zgjatje të tillë të afatit. Më 12 dhjetor 2012, AKP-ja parashtri kërkesë për zgjatje prej 30 ditëve të afatit dhe Gjykata me aktvendimin C-V.-13-0012, aprovoi këtë kërkesë të AKP-së bazuar në atë se AKP-ja ende duhet të angazhojë Ofruesin e Shërbimeve Profesionale. Gjykata kuptoi se formulimi i nenit 19 në kuptimin e zgjatjes së afatit prej 30 ditësh mund të aprovohet vetëm një herë. Më tutje theksohet se interpretimi i tillë është logjik duke pasur parasysh se afati në fjalë përlllogaritet kur ditët kalendarike i shtohen datës së afatit për parashtrimin e kërkesës ("90 ditë më pas") pasi shtesa në dispozicion përcaktohet në dispozitë, nuk mund të lejohet zgjatje e mëtutjeshme. Kolegji i Specializuar vjen në përfundim se zgjatja e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve nuk është e mundur dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Lidhur me kërkesën për të zgjatur afatin e Planit të Riorganizimit, Kolegji i Specializuar theksoi se është shumë e qartë se AKP-ja është " krejtësisht e papërgatitur që madje të fillojë me hartimin e Planit".

Kolegji i Specializuar konsideron se është gjë e ditur se 3 nga 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve janë dorëhequr kohë më parë dhe vendet e lira ende nuk janë plotësuar. Që nga prill 2013, Bordi funksionon me vetëm 5 drejtorë. Veç kësaj - me 31 gusht 2014, mandati i dy anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit skadon dhe përderisa Kuvendi i Kosovës nuk emëron zëvendësimet, Bordi do të jetë krejtësisht jo-funksional dhe krejtësisht e mundur që zëvendësimet nuk do të bëhen për muaj të tërë. Përveç kësaj, që nga shkurti 2014, Agjencia nuk ka Drejtor Menaxhues. Prandaj gjykata vendosi të zgjasë afatin për Planin e Riorganizimit në kufirin maksimal të pranueshëm - 2 shkurt 2015 i cili do jetë në total 15 muaj, si zgjatje maksimale që do të mund të lejohej sipas ligjit të zbatueshëm 04/-035.

Më 22 gusht 2014, AKP-ja ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Ankesave për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Kolegji i Specializuar i DHPGJS nuk vlerësoi siç duhet mungesën e Drejtorit Menaxhues, skadimin e mandatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, si dhe gjendjen e përgjithshme të institucioneve publike të Kosovës, përkatësisht mosfunksionimin e Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve të qershorit 2014. Për më tepër mandati i anëtarit ndërkombëtar të Bordit të Drejtorëve skadon më 31 gusht 2014. AKP-ja ka deklaruar se miratimi i pjesshëm i kërkesës së AKP-së për vetëm 8 muaj për përgatitjen e Planit për Riorganizim nuk është i mjaftueshëm dhe asnjë nga kompanitë e huaja do të ofertojnë në një tender për ofrues të shërbimeve profesionale në një periudhë kaq të shkurtër realizimi.

AKP-ja ka deklaruar se dispozita 42.4 nënkupton se gjykata ka të drejtë të zgjasë çdo afat kohor në rast se konsideron që rrethanat e shohin të nevojshme. AKP-ja i propozoi Kolegjit të Ankesave të: aprovojë ankesën e AKP-së si të bazuar dhe të anulohet në tërësi aktvendimin e ankimuar; të aprovojë kërkesën e AKP-së për vazhdimin e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve jo më vonë se 30 qershori 2015; të aprovojë kërkesën e AKP-së për zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e Planit për Riorganizim deri më 31 dhjetor 2015; të detyrojnë AKP-në të publikojë këtë aktvendim në ueb-faqen zyrtare të AKP-së, në mediat e shkruara vendore dhe rajonale.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Shtojca), Kolegji i Ankesave vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.

Sipas nenit 19.1 të Ligjit për Riorganizimin, Administratori cakton datën për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditëve pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Me

kërkesë të Administratorit, Gjykata mund të zgjasë periudhën kohore për mbajtjen e Mbledhjes së Parë të Kreditorëve për tridhjetë (30) ditë shtesë.

Sipas nenit 22.1 të Ligjit për Riorganizimin, brenda nëntë (9) muajve pas datës së publikimit të Njoftimit për afatin e parashtrimit të kërkesave në pajtim me nenin 17 të këtij ligji, Administratori përgatit Planin e propozuar për Riorganizim dhe do ta dorëzon atë plan para Komisionit të Kreditorëve. Një kopje e këtij plani i dorëzohet në të njëjtën kohë gjykatës. Gjykata mund të zgjasë periudhën nëntëmujore në maksimalisht pesëmbëdhjetë (15) muaj pas një apo më shumë kërkesave të dorëzuara në Gjykatë nga Administratori, përfshirë arsyet për një kërkesë të tillë.

Sipas nenit 42.4 të Ligjit për Riorganizimin, Gjykata mund të zgjasë çdo kufizim kohor të përcaktuar me dispozita të këtij ligji, përveç nëse dispozita në fjalë përbën kufizim specifik të autoritetit të gjykatës në lidhje me kufizimin e tillë.

Lidhur me zgjatjen e afatit për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve, AKP-ja, më herët më 12 dhjetor 2013, ka dorëzuar kërkesën e parë për zgjatjen e afatit për 30 (tridhjetë) ditë, sipas dispozitës së lartpërmendur. Kolegji i Specializuar i DHPGJS me aktvendimin C-V.-13-0012 të datës 17 janar 2014, aprovoi kërkesën e AKP-së për zgjatjen e afatit për 30 (tridhjetë) ditë shtesë, ku AKP-ja duhej të paraqiste një "raport përmbledhës për procesin e përgatitjes për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve jo më vonë se 15 marsi i vitit 2014. Duke marrë parasysh këtë zgjatje të parë të afatit atëherë aktvendimi i Kolegjit të Specializuar lidhur me hedhjen poshtë si të papranueshme të kërkesës së dytë për zgjatje të afatit (rasti në fjalë) është i drejtë. Neni 19.1 i Ligjit për Riorganizim lejon vetëm një zgjatje të afatit nga 30 (tridhjetë) ditë e cila shihet nga formulimi "për tridhjetë (30) ditë shtesë". Ky është pikërisht "kufizim specifik mbi autoritetin e Gjykatës për të zgjatur afatin në fjalë" i përmendur shprehimisht në nenin 42.4 të

Ligjit për Riorganizimin. Për më tepër çfarëdo afati i mundshëm për Mbledhjen e Parë të Kreditorëve është tërësisht i humbur.

E njëjtë është situata në lidhje me zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit për Riorganizim për "Ndërmarrjen Trepça". Me aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, AC-I.-12-0131 të datës 12 shkurt 2013, ishte aprovuar kërkesa që AKP-ja të zgjatë afatin për shpalljen e njoftimit për afatin e parashtrimit të kërkesave deri më 1 nëntor 2013. Nga kjo datë, në bazë të nenit 22.1, AKP-ja brenda nëntë (9) muajve duhej të përgatiste Planin e propozuar të Riorganizimit dhe të paraqesë planin e tillë tek Komisioni i Kreditorëve, ndërsa Gjykata mund ta zgjasë këtë afat deri në maksimumin prej pesëmbëdhjetë (15) muajsh - Neni 22.1 i Ligjit mbi Riorganizimin. Ky "maksimum prej pesëmbëdhjetë (15) muajsh" paraqet përsëri "kufizimin specifik mbi autoritetin e Gjykatës për të zgjatur afatin në fjalë" të përmendur shprehimisht në nenin 42.4 të Ligjit për Riorganizimin. Gjithashtu nga interpretimi gjuhësor i fjalës "maksimum" është e qartë se ajo në të vërtetë do të thotë diçka që nuk mund të tejkalohet. Kolegji i Ankesave në përputhje me rrethanat konstaton se ky afat është zgjatur në mënyrë të duhur nga Kolegji i Specializuar të DHPGJS-së në një kufi maksimal të mundshëm deri me 2 shkurt 2015 dhe nuk mund të shtyhet tutje.

Meqë afatet e caktuara me ligji janë përfundimtare (pas kohëzgjatjeve të mëparshme) dhe nuk mund të zgjaten më shumë argumentimi i AKP-së duke mos pasur Drejtor Menaxhues, skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, mosfunksionimit të Kuvendit e Kosovës dhe mosgatishmërinë e kompanive të huaja për të konkurruar në një tender për ofrues të shërbimeve profesional është jo relevante. Prandaj aktvendimi i ankimuar vërtetohet.

Dhoma e Posaçme e sheh të arsyeshme t`ia rikujtojë AKP-së dhe Drejtorëve të saj detyrat e tyre të qarta ligjore për të proceduar me riorganizimin e " Ndërmarrjes Trepça " sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mos kërkojë gjithnjë për zgjatje të çdo afati të mundshëm ligjor.

Kolegji i Ankesave ka bërë korrigjim të një gabimi të dukshëm në shkrim, andaj dispozitivi, pika 2 e aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të datës 31 Korrik 2014 C-V-14-0007, duhet të jetë e shkruar si vijon: kërkesa e AKP-së e ngritur në cilësinë e njëjtë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Planit për Riorganizim për "Ndërmarrjet Trepça" është aprovuar deri më 2 shkurt 2015 (dispozitivi, pika 2). Është e qartë se në pikën 2 të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar gabimisht ishte shkruar data e gabuar 2 prill 2015 në vend të asaj të saktë 2 shkurt 2015, pasi që është e qartë nga arsyetimi në faqen 5, paragrafi i katërt i aktvendimit të ankimuar ku përmendet në mënyrë të qartë se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vendos ta zgjasë afatin deri me 2 shkurt 2015 si kufi maksimal i pranueshëm.

Si rrjedhim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore shtesë për procedurë ankimore pasi ankuesi tashmë ka paguar 100 euro.

Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

